

VENDIM
Nr. 519, datë 20.9.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT
DHE UJIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 738, datë 13.12.2017; nr. 820, datë 26.12.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, si autoritet kombëtar i planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe si organ qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore të Republikës së Shqipërisë, kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje:

<i>- ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë</i>	<i>anëtar;</i>
<i>- ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit</i>	<i>anëtar;</i>
<i>- ministrin e Drejtësisë</i>	<i>anëtar;</i>
<i>- ministrin e Turizmit dhe Mjedisit</i>	<i>anëtar;</i>
<i>- ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</i>	<i>anëtar;</i>
<i>- ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit</i>	<i>anëtar;</i>
<i>- ministrin e Mbrojtjes</i>	<i>anëtar;</i>
<i>- ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	<i>anëtar;</i>
<i>- ministrin e Financave</i>	<i>anëtar;</i>
<i>- drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit</i>	<i>anëtar dhe sekretar.</i>

2. Kur, për shkaqe të arsyeshme, Kryeministri apo ministri anëtar nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë në vend të tij merr pjesë, përkatësisht, me të drejtë vote:

- personi i autorizuar nga Kryeministri, i cili kryeson mbledhjen;
- zëvendësministri, përfaqësues i ministrit në mungesë.

3. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen me 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit të përballohet nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës që ata përfaqësojnë.

5. Sekretariati teknik i KKTU-së zbaton vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, të cilat ua dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit, dhe ministrit të linjës për zhvillimin e propozuar. Vendimet nënshkruhen edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e sekretarit të KKTU-së. Vendimet nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit dhe hyjnë në fuqi menjëherë.

Në rastin e zbatimit të vendimeve, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, sekretariati teknik koordinon veprimet me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet për dhënie lejeje apo autorizimi, në zbatim të legjislacionit për burimet ujore, nënshkruhen edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore. Vendimet nënshkruhen nga kryetari, ministri i linjës dhe, kur është rasti, dhe nga sekretari i KKTU-së, dhe hyjnë në fuqi menjëherë.

6. Vendimi nr. 1097, datë 28.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen të gjitha institucionet, përfaqësuesit e të cilave janë përcaktuar në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi